



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.10, nenit 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73 dhe 127, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 20, 21 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 06.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 02/2024

EMËRIMI, PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procedurat për themelimin, përbërjen, dhe përgjegjësitë e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), kriteret për emërim të anëtarëve të KKZ, zëvendësimin, shkarkimin, përfundimin e mandatit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të KKZ, funksionimin, vulën, orarin e punës, mbledhjet, procedurën e zhvillimit të mbledhjeve, vendimmarrjen, konfliktin e interesit dhe dokumentacionin e KKZ.

Neni 2

Themelimi dhe përbërja e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ)

1. KKZ ka shtatë (7) anëtarë. Ky numër mund të rritet, nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh, në këtë rast KQZ vendos në bazë të numrit të banorëve dhe numrit të votave të atij subjekti politik në komunën përkatëse.
2. KKZ përbëhet nga:
 - 2.1. Zyrtari Ekzekutiv i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (ZEKKZ), i punësuar nga KQZ, i cili njëkohësisht është kryesues i KKZ-së;
 - 2.2. nga një anëtar i nominuar nga secili subjekt politik që ka kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, nëse i nënshtrohet pragut zgjedhor.

3. Anëtarët e KKZ janë persona me të drejtë vote në komunën përkatëse, me përvojë administrative ose zgjedhore dhe kanë njohuri të mjaftueshme, që i mundëson KKZ të kryejë detyrën e vet në mënyrë efektive.
4. KQZ duhet të përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të banorëve brenda komunës përkatëse dhe përfaqësimin gjinor, më së paku 30% në nivel vendi për të gjitha subjektet politike.

Neni 3

Paraqitja e propozimeve nga subjektet politike për anëtarë të KKZ

1. KQZ, jo më larg se dy ditë nga shpallja e zgjedhjeve, u dërgon njoftimin subjekteve politike që kanë të drejtë të paraqesin nominimet e tyre për anëtarë të KKZ, sipas nenit 2 të kësaj Rregullore. Njoftimi përmban ftesën për nominim dhe kriteret e përcaktuara sipas LZP.
2. Subjektet politike, jo më larg se 8 ditë nga dita e pranimit të njoftimit, duhet t'i paraqesin nominimet në KQZ.
3. Lista e nominimeve përmban: emrin dhe akronimin e subjektit politik, emrin, mbiemrin, vendbanimin, kualifikimin dhe numrin personal të të nominuarit shtojca I, Formulari i nominimeve nga subjektet politike.
 - 3.1. Subjektet politike dorëzojnë listën e nominimeve me së paku 30% të secilës gjini në nivel vendi.
4. Së bashku me të dhënat si në paragrafin 3 të këtij neni, nominimit i bashkëngjitet dokumentacioni, si në vijim:
 - 4.1. letërnjoftimi;
 - 4.2. dëshmia e kualifikimit shkollor;
 - 4.3. numri i llogarisë bankare;
 - 4.4. vërtetimi mbi marrëdhënien e punës – kontrata e punës (nëse është në marrëdhënie pune);
 - 4.5. certifikatë mbi dënimet penale, që vërteton se personi nuk ka qenë i dënuar për veprë penale me vendim të formës së prerë të gjykatës në tre (3) vitet e fundit;
 - 4.6. formulari i kandidatit shtojca II – Formulari i kandidatit.

Neni 4

Kualifikimi dhe kriteret për emërim të KKZ

1. Personi i nominuar për anëtar të KKZ, duhet t'i plotësojë këto kriteret:
 - 1.1. të jetë votues i komunës përkatëse;
 - 1.2. të ketë të përfunduar shkollën e mesme, preferohet arsimimi universitar;

- 1.3. preferohet të ketë përvojë pune në administratë/zgjedhje;
- 1.4. të mos jetë i dënuar për veprë penale me vendim të formës së prerë të gjykatës në tre (3) vitet e fundit.
2. Asnjë person nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KKZ, ose të vazhdojë të shërbejë, nëse ai është:
 - 2.1. deputet i Kuvendit të Kosovës apo në ndonjë shtet tjetër;
 - 2.2. këshilltar i ndonjë kuvendi komunal në Kosovë;
 - 2.3. kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik në Kosovë;
 - 2.4. zyrtar i lartë publik në parti politike, sipas regjistrimit të KQZ-së;
 - 2.5. person pa të drejtë vote në Kosovë;
 - 2.6. person të cilit me vendim gjyqësor i është hequr zotësia e veprimit;
 - 2.7. anëtar i komisionit publik zgjedhor jashtë Kosovës;
 - 2.8. person të cilit i është ndaluar shërbimi në cilësinë e anëtarit të KKZ nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP);
 - 2.9. anëtar i organizatës jo-qeveritare, që i monitoron zgjedhjet;
 - 2.10. i larguar nga puna nga administrata publike, për shkelje të ligjit;
 - 2.11. i dënuar në tri (3) vitet e fundit, me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, me një ose më shumë vjet burg efektiv;
 - 2.12. funksionar publik me status të veçantë, në bazë të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë, brenda ose jashtë Kosovës, në pesë (5) vitet e fundit, shtojca VI – formulari i përshtatshmërisë mbi deklaratën e betimit.

Neni 5

Emërimi i anëtarëve të KKZ

1. KQZ emëron me vendim anëtarët e KKZ të nominuar nga subjektet politike, brenda 15 ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve, sipas kriterëve të neneve 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregullore.
2. Anëtarët e KKZ, pas emërimit nga KQZ, pajisen me certifikatë të emërimit, në të cilën shënohet data fillimit dhe përfundimit të emërimit, pajisen me kontratën e punës, distinktivin dhe kodin e sjelljes, shtojca IV – Certifikata e Emërimit.
3. Kur KQZ refuzon një kandidat të nominuar për shkak të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregullore, kërkon nga subjekti politik të nominojë një kandidat tjetër brenda tre (3) ditëve. KQZ brenda dy (2) ditëve pas pranimit të nominimit të merr vendim.

4. Kundër vendimit të KQZ për mos emërimin e anëtarit të KKZ, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të parashetrojnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ.

Neni 6

Përfundimi i mandatit të anëtarit/es të KKZ

1. Mandati i anëtarit të KKZ përfundon:
 - 1.1. Me përfundim të mandatit;
 - 1.2. me revokim nga KQZ;
 - 1.3. me dorëheqje;
 - 1.4. me kërkesë të subjektit politik;
 - 1.5. me humbje të kritereve të nominimit;
 - 1.6. me vdekje.
2. Mandati i anëtarit të KKZ përfundon 15 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse ky mandat ndërpritet ose zgjatet, para përfundimit të mandatit.
3. Anëtarit të KKZ i revokohet emërimi me vendim të KQZ, nëse:
 - 3.1. Nuk i kryen detyrat e tij/saj sipas rregulloreve të KQZ;
 - 3.2. vepron në mënyrë të njëanshme dhe joprofesionale;
 - 3.3. nuk merr pjesë në dy takime të njëpasnjëshme të KKZ, pa ndonjë arsye të bazuar;
 - 3.4. merr pjesë në një fushatë zgjedhore në emër të një subjekti politik, ose ndërhyr në procesin zgjedhor;
 - 3.5. nuk lajmërohet në punë dy (2) ditë me radhë, pa ndonjë arsye të qëndrueshme.
4. Kryesuesi i KKZ mund të iniciojë kërkesë në KQZ, për revokim të emërimit të anëtarit të KKZ-së, në rast se anëtari vepron në kundërshtim me LQP, rregulloret e KQZ dhe Kodin e Sjelljes për anëtarët e KKZ.
5. KQZ, sipas paragrafit 3 të këtij neni, vendos jo me vonë se dy (2) ditë pas pranimit të kërkesës për revokim.
6. Në secilin rast, KQZ i kërkon subjektit politik, anëtarit të të cilit i përfundon mandati sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij neni, të bëjë nominimin e ri brenda 3 ditëve.
7. Anëtari i dorëhequr apo i shkarkuar i KKZ, obligohet t'i dorëzojë të gjitha pajisjet e ngarkuara nga KQZ dhe KKZ.

Neni 7

Konstituimi i KKZ

1. Mbledhja konstituive e KKZ thirret nga kryesuesi, brenda dy (2) ditëve pas emërimit nga KQZ.
2. Njoftimi për mbledhjen konstituive u dërgohet anëtarëve të KKZ, përmes subjekteve të tyre politike.
3. Pas konstituimit, KKZ përcakton orarin e mbledhjeve të rregullta.

Neni 8

Zëvendësimi i anëtarëve në KKZ

1. Kur pozita e një anëtari të KKZ mbetet e lirë, subjekti politik dorëzon nominimin për anëtarin e ri, brenda tri (3) ditëve.
2. Emërimi i anëtarit të ri bëhet nga KQZ, brenda dy (2) ditëve.
3. Kur anëtari i KKZ jep dorëheqje, deklarata e dorëheqjes i dorëzohet ZEKZZ, i cili e percjellë menjëherë në KQZ.

Neni 9

Përgjegjësitë e KKZ

1. KKZ administron zgjedhjet brenda komunës përkatëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe sipas udhëzimeve të KQZ, duke garantuar ligjshmëri, paanshmëri dhe efikasitet të procesit zgjedhor.
2. KKZ harton planin e aktiviteteve zgjedhore në nivel lokal, me të cilin parashihen të gjitha aktivitetet dhe afatet e realizimit të tyre, i cili bëhet publik.
3. KKZ drejton punën në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), sipas Rregullores për QKN. Kryesuesi i KKZ është menaxher i QKN.
4. KKZ bën pranimin dhe shpërndarjen materialit zgjedhor, percjelljen dhe pritjen e ekipeve mobile për votimin e personave me nevoja të veçanta.
5. KKZ zbaton procedurat e parapara për fushatën zgjedhore dhe cakton një anëtar të KKZ, i cili koordinon aktivitetet zgjedhore me institucionet përkatëse.
6. KKZ, në pajtim me udhëzuesin, përpilon listën e menaxherëve të Qendrave të Votimit (QV) dhe e percjell në KQZ, shtojca VII – udhëzimi për caktimin e menaxherëve dhe personelit teknik të QV.
7. KKZ i dorëzon listat e anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit (KVV) dhe ekipeve të numërimit në QKN për miratim në KQZ, të cilët do të angazhohen për procesin zgjedhor,

duke u bazuar në formulën e miratuar nga KQZ.

8. KQZ përmes KKZ organizon fushatë informuese në komunat përkatëse, e cila veçanërisht ju adresohet grupeve shoqërore, si: gratë, komunitetet joshumicë, votuesit në zonat rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me nevoja të veçanta.
9. KKZ në baza ditore rapoton në KQZ për vendimet dhe aktivitete tjera ditore, sipas formatit të përcaktuar nga KQZ.

Neni 10

Funksionimi dhe kompetencat e KKZ

1. Përveç detyrave të përcaktuara në nenin 68, paragrafi 1 i LZP, KKZ ushtron edhe këto kompetenca:
 - 1.1. Njofton subjektet politike të certifikuara dhe oganizatrat jo qeveritare (OJQ), për programin e trajnimit të KVV, të organizuara nga KQZ;
 - 1.2. ndërmerr masat për mbarëvajtjen e trajnimeve, si dhe evidenton pjesëmarrësit në trajnim;
 - 1.3. bashkëpunon me drejtoritë komunale të arsimit apo institucionet tjera, për sigurimin e ambienteve dhe bazës së nevojshme logjistike, për trajnimin e stafit zgjedhor dhe sistemimin e materialit zgjedhor;
 - 1.4. vendosë në vendet publike informatat që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në kuadër të komunës së tyre përkatëse;
 - 1.5. shqyrton dhe merr vendime për të gjitha kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga subjektet politike, që janë në kompetencë të tyre;
 - 1.6. mbikëqyrë përgatitjen e hapësirave të QV dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore në QKN, deri në përfundimin e procesit të zgjedhjeve;
 - 1.7. për kryerjen e detyrave dhe funksionimin e KKZ, kryesuesi i KKZ, në konsultim me antarët e KKZ, i ndan detyrat administrative-teknike;
 - 1.8. kryesuesi i KKZ kërkon nga subjektet politike të caktojnë person kontaktues me KKZ;
 - 1.9. anëtari i KKZ është i detyruar të paraqitet me rregull në punë, në përputhje me dinamikën dhe vëllimin e punës së KKZ;
 - 1.10. në ushtrimin e funksionit të tij, anëtari i KKZ duhet të respektojë ligjin dhe rregulloret e KQZ.
2. KKZ duhet që aktivisht ta monitorojnë shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audiovizuale dhe të çfarëdo materiali tjetër zgjedhor të subjekteve politike të certifikuara, gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve.
3. Në rast të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për zgjedhjet, ose të dispozitave të përcaktuara

me LZP, apo rregulloret e KQZ, KKZ menjëherë duhet ta informojnë subjektin politik në fjalë që të marrë masa korrigjuese brenda njëzet e katër (24) orëve.

4. Nëse shkeljet përsëriten nga i njëjti subjekt politik apo i njëjti refuzon që t'i korrigjojë shkeljet e identifikuar, KKZ brenda njëzet e katër (24) orëve raporton rastin në PZAP.

Neni 11

Kompenzimi i anëtarëve të KKZ

1. Anëtarët dhe kryesuesi i KKZ paguhet për kryerjen e detyrave të tyre nga burimet e KQZ, në pajtim me rregullat e miratuara për këtë qëllim.
2. Anëtarët e KKZ-së të punësuar në administratë, marrin pagesë që është e barabartë me gjysmën e pagës së anëtarit të KKZ-së, si shtesë e pagës së tyre të zakonshme.
3. KKZ ka të drejtë për kompenzim të mjeteve të shpenzuara për përfaqesim, të cilat arsyetohen nga kryesuesi i KKZ dhe nuk tejkalojnë shumën njëqind (100) euro brenda një muaji, në periudhën e procesit zgjedhor, deri në certifikimin e rezultateve.

Neni 12

Zyra e KKZ

1. Vendndodhja e zyrave të KKZ, duhet të jetë brenda objekteve të administratës komunale apo në hapësirën e përcaktuar si QKN, të cilat duhet t'i plotësojnë kushtet për punë.
2. Në zyrën e KKZ vendosen simbolet e Republikës së Kosovës dhe të KQZ.
3. Në hyrjen kryesore të zyrës së KKZ, vendoset tabela njoftuese e KKZ dhe emrat e anëtarëve të KKZ, e-maili zyrtar i ZEKKZ-së, numri i telefonit të zyrës dhe orari i punës.
4. Zyra e KKZ duhet të jetë e pajisur me mjetet e nevojshme të punës.
5. Komunitatet përkatëse janë të obliguara që t'i ofrojnë mbështetjen e nevojshme logjistike KKZ, duke siguruar: hapësira për punë, depo për materiale, transport, objektet publike për nevoja të votimit, ambiente tjera për organizimin e trajnimeve të komisionerëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për vendosjen dhe punën e QKN.
6. Në rast të pamundësisë së përmbushjes të kushteve, sipas paragrafit 5 të këtij neni, KQZ është e obliguar t'i plotësojë nevojat për funksionimin e KKZ.

Neni 13

Dokumenti i identifikimit (distinktivi)

Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët e KKZ janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit (distinktivi), të lëshuar nga KQZ.

Neni 14

Vula e KKZ

1. KKZ përdor vulën e miratuar nga KQZ për zgjedhjet përkatëse.
2. Vula e KKZ mbahet nga kryesuesi i KKZ, i cili e administron atë, në përputhje me Ligjin mbi përdorimin e vulave zyrtare, LZP dhe aktet tjera të KQZ.
3. Vula e KKZ vendoset në të gjitha aktet e nxjerra dhe të miratuara nga KKZ, të nënshkruara nga kryesuesi i KKZ.
4. Vula nuk mund të nxirret në asnjë rrethanë jashtë ambienteve të punës të KKZ.
5. Në rast se vula e KKZ bëhet e papërdorshme, humbet ose nxirret jashtë zyrës së KKZ, përpilohet shënim zyrtar, i cili evidentohet në librin e protokollit. KKZ njofton KQZ me shënimin zyrtar.
6. KQZ, pas vlerësimit të shënimit zyrtar të KKZ, e pajisë KKZ me vulën e re.

Neni 15

Orari i punës së KKZ

1. Orari i punës së KKZ është nga ora 8:00 -16:00. Për nevoja të kryerjes së detyrave shtesë, orari mund të zgjatet. Anëtarët e KKZ-së janë të obliguar të respektojnë orarin e punës.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kryesuesi i KKZ e përcakton orarin e punës sipas nevojës, dinamikës dhe aktiviteteve në kuadër të KKZ.

Neni 16

Mbledhjet e KKZ

1. Mbledhjet mbahen në zyrat e KKZ.
2. Mbledhjet e rregullta thirren nga kryesuesi, ose nga së paku tre anëtarë të KKZ, të paktën 24 orë para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimi për mbledhje përmban: datën, vendin, orën dhe rendin e ditës. Ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren brenda ditës nga kryesuesi, jo më vonë se tri orë para takimit.
3. Kuorumin e mbledhjes e përbëjnë prania e shumicës së anëtarëve të KKZ.
4. Mbledhjet e KKZ janë publike.
5. Mbledhja e KKZ drejtohet nga kryesuesi, ndërsa në mungesë të tij, nga një anëtar i KKZ, të cilin e cakton kryesuesi, sipas rotacionit.

6. Çdo anëtar i KKZ paraqet propozimin për rend të ditës dhe diskuton për çështjet që janë në rend të ditës.
7. Procesverbali i mbledhjeve të KKZ evidentohet në librin e protokollit, i cili duhet të përmbajë:
 - 7.1. Datën, vendin, orën e mbajtjes dhe rendin e ditës;
 - 7.2. pjesëmarrësit dhe mungesat;
 - 7.3. përmbajtjen e diskutimeve;
 - 7.4. rezultatet e votimit të anëtarëve të KKZ
 - 7.5. vendimet që merren duhet të vulosen.
8. Pas përfundimit të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi dhe procesmbajtësi, dhe të shënohen votat për, kundër dhe abstenim për secilin vendim, të cilin e caktojnë me shumicë votash anëtarët prezentë, i cili evidentohet në librin e protokollit.

Neni 17

Vendimmarrja

1. KKZ provon të vendosë me konsensus. Kur konsensusi nuk është i mundur, atëherë vendoset me shumicën e votave të gjithë anëtarëve prezentë, sipas paragrafi 3 të nenit 16, kësaj Rregullore.
2. Vendimet e KKZ nënshkruhen dhe vulosen nga kryesuesi KKZ.
3. KKZ obligohet t'i bëjë menjëherë publike vendimet dhe t'i dërgojë në KQZ për publikim në faqen zyrtare.
4. Anëtari i KKZ mund të komunikojë dhe informojë KQZ për çdo çështje që ai e sheh të arsyeshme, e cila nuk ka mundur të zgjidhet në KKZ.
5. Ndaj vendimeve të KKZ, anëtari mund të parashtrijë ankesë në KQZ.

Neni 18

Materialet e KQZ për informim publik

1. Autoritetet komunale duhet t'i caktojnë vendet e posaçme për ekspozimin e materialit të shtypur të zgjedhjeve dhe të materialit për informim publik, të përgatitur nga KQZ.
2. Vendet e tilla duhet të caktohen në hapësirat më të frekuentuara dhe më të dukshme në komunën përkatëse.
3. KQZ, përmes ZEKKKZ, komunikon me autoritetet komunale për përcaktimin e hapësirave ku KQZ mund të vendosë materialet zgjedhore, për informim publik.

4. KQZ mund t'i lejojë KKZ-së hapjen e llogarive në rrjetet sociale me qëllim të informimit publik.

Neni 19

Konflikti i interesit

1. Asnjë anëtar i KKZ nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me çështjen në të cilën anëtari i familjes ka interesa të natyrës personale ose financiare, e që mund ta vë në dyshim paanshmërinë e anëtarit.
2. Anëtari që ka konflikt interesi, duhet të vetëdeklarojë një gjë të tillë..
3. Asnjë KKZ nuk mund të pranojë në emër të funksionit që ushtron, çfarëdo kompensimi në formë monetare apo materiale, nga persona fizik apo juridik, përveç atyre që janë përcaktuar nga KQZ.

Neni 20

Dokumentacioni i KKZ

1. Kryesuesi i KKZ është përgjegjës për arkivimin dhe sistemimin e dokumentacionit zgjedhor të KKZ, krijon dosje të veçantë për vendimet dhe udhëzimet e KQZ, si dhe mban dosje për aktet e tjera të nxjerra nga KKZ.
2. Format e shkresave të KKZ janë unike dhe përpilohen nga KQZ.
3. Me kërkesë të subjekteve politike, jepet kopja e akteve.

Neni 21

Shfrytëzimi i pajisjeve

ZEKKZ sigurohet që të gjitha pajisjet e pranuar nga KQZ, për qëllim të kryerjes së funksioneve gjatë procesit zgjedhor, pas përfundimit të procesit, të njejtat duhet t'i kthej në KQZ.

Neni 22

Dispozitat përfundimtare

1. Çështjet që lidhen me punën e KKZ, e që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, përcaktohen me vendim ose ndonjë akt tjetër të KQZ, në përputhje me LZP.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr. 02/2023 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, e datës 09.03.2023.
3. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:
 - 3.1. Shtojca I – Formulari i nominimeve nga subjektet politike;
 - 3.2. Shtojca II – Formulari i kandidatit;
 - 3.3. Shtojca III – Formulari i emërimeve;
 - 3.4. Shtojca IV – Certifikata e emërimit;
 - 3.5. Shtojca V – Kodi i Sjelljes për anëtarët e KKZ;
 - 3.6. Shtojca VI – Formulari i përshtatshmërisë mbi deklaratën e betimit;
 - 3.7. Shtojca VII – Udhëzimi për caktimin e menaxherëve dhe personelit teknik të QV.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi